

URDHËRESË
Nr.7, datë 17.8.1993

PËR TRANSPORTIN RRUGOR PUBLIK TË UDHËTARËVE DHE BAGAZHEVE

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve dhe të Komunikacioneve, në bazë të nenit 245 të Kodit civil, Këshilli i Ministrave nxjerr këtë

URDHËRESË:

KREU I
MARRËDHËNIET UDHËTAR-TRANSPORTUES

Neni 1

Me këtë urdhëresë rregullohet transporti rrugor publik i udhëtarëve dhe i bagazheve të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Prerja e biletës a faturimi i automjetit përbëjnë një lidhje kontrate, për zbatimin e së cilës transportuesi dhe udhëtari ngarkohen me detyrime e të drejta të ndërsjella.

Neni 3

Transportuesi ka për detyrë:

- Të sigurojë transportimin e udhëtarëve e të bagazheve të tyre deri në fund të udhëtimit;
- Të sigurojë kushtet e përshtatshme për udhëtarët dhe bagazhet e tyre gjatë udhëtimit, sipas kriterëve të shpallura që më parë.
- Të sigurojë ruajtjen e bagazheve që merr përsipër të transportojë, sipas dëftesës që atyre u bashkëngjitet, dhe të përgjigjet për humbjen a dëmtimin e tyre, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 243 të Kodit Civil.
- Të shpërblejë udhëtarin, në rastet e humbjes së bagazhit, në msaën e vlerës së deklaruar. Kur provohet që vlera e vërtetë e bagazhit është më e vogël se ajo e deklaruar, shpërblimi jepet në përputhje me vlerën e vërtetë të tij.
- Të shpërblejë udhëtarin, në rastet e dëmtimit të bagazhit, në masën e vlerës për pjesën e dëmtuar.
- Të sigurojë mjet tjetër në rastet e ndërprerjes së udhëtimit për defekt të mjetit në linjë. Nëse udhëtimi ndërpritet me forcë madhore, siguron kthimin e udhëtarëve pa pagesë në vendin e nisjes, si dhe kthen vlerën e biletës kundrejt paraqitjes së saj nga ana e udhëtarit.
- Të mbajë pastër automjetin si në pjesën e kabinës, ashtu edhe pjesën e caktuar për mbajtjen e bagazheve të udhëtarit. Ndalohet mbajtja e pjesëve rezervë në kabinë.

Neni 4

Udhëtari ka për detyrë:

- Të jetë i pajisur me biletë udhëtimi dhe kopje dëftese për marrjen e bagazhit, sipas largësisë që do të udhëtojë, dhe t'i ruajë ato deri në fund të udhëtimit.
- Të paraqitet në stacionin e nisjes brenda orarit të shënuar në biletë ose të shpallur në stacion. Transportuesi nuk mban përgjegjësi nëse udhëtari nuk paraqitet në orar dhe nuk kthan vlerën për udhëtimin e pakryer.
- Të marrë me vete bagazhe të përshtatshme për transport me autobus, sipas rregullit të caktuar që më parë nga transportuesi për madhësinë e tyre.
- Ndalohet transportimi me mjete të transportit publik i lëndëve djegëse, plasëse e gërryese dhe i sendeve të tjera që rrezikojnë jetën e udhëtarëve.

- Të zbatohet rregulla të udhëtimit të caktuar nga transportuesit.
- Ndalohet pirja e duhanit në autobus.

Neni 5

Udhëtari dhe transportuesi kanë të drejtë të kërkojnë ndaj njëri-tjetrit zbatimin e detyrimeve të ndërsjella, me synim që të krijohen kushte sa më të mira për udhëtim.

KREU II TRANSPORTI

Neni 6

Transporti rrugor publik i udhëtarëve dhe i bagazheve të tyre lejohet vetëm me mjete të përshtatshme të prodhuara për këtë qëllim dhe që bëhen objekt i kësaj urdhërese, sipas përkatësisë së tyre, në dispozitat e mëposhtme.

Mjetet e transportit rrugor publik të udhëtarëve përmbushin kushtet për kryerjen e transportit vetëm pasi i plotësojnë kërkesat për sigurimin teknik në rrugë, konfortin e nevojshëm sipas llojit të transportit dhe pamjen e jashtme të tyre, sipas kriterëve që përcakton Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.

Transporti rrugor publik i udhëtarëve dhe i bagazheve të tyre kryhet me leje dhe i lirë.

Neni 7

Transporti rrugor publik i udhëtarëve, i cili i nënshtrohen sistemit të lejeve, është i përkohshëm dhe i vazhdueshëm.

Neni 8

Pavarësisht nga lloji i lejeve dhe organet shtetërore që i lëshojnë, transportuesit janë të detyruar t'i nënshtrohen sistemit të evidencës dhe shtesave të kërkuara për aidentim nga organet shtetërore të ngarkuara me transportin.

Neni 9

Gjatë kryerjes së transportit rrugor publik të udhëtarëve dhe të bagazheve të tyre transportuesi duhet të ketë me vete lejen ose dokumente të njëvlefshme të vërtetuara në organet noteriale, kur transporti kryhet me leje.

Kur kryhet transporti i lirë i udhëtarëve, në kabinën e mjetit duhet të jenë të plotësuara të gjitha dokumentet e nevojshme që kërkohen nga kjo urdhëresë, ose nga organe të ngarkuara për drejtimin e transportit të atij lloji.

Neni 10

Miratimi i lejes për transport lëshohet në emrin e transportuesit, i cili bën kërkesën dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar nga Ministria e Transporteve dhe e Telekomunikacioneve.

Neni 11

Formati i lejes së transportit dhe përmbajtja e saj miratohen nga Ministria e Transporteve dhe e Telekomunikacioneve.

Neni 12

Leja për transport mund të hiqet kur:

1. Nuk plotësohet një nga kushtet për dhënien e saj.
2. Nuk fillon veprimtaria brenda 90 ditëve nga data e lëshimit të lejes.
3. Kur nuk respektohen linjat a oraret sipas radhës, ose kryhen transportime në linja a orarë që nuk janë shënuar në leje.
4. Nuk qëndrohet në stacionet e vendosura në leje.
5. Qëndrohet në stacione që nuk janë vendosur në leje.
6. Kur ndërpret kryerjen e veprimtarisë së transportit.
7. Në rastet e mbylljes së veprimtarisë së transportuesit.

Nëse leja për transport hiqet në bazë të pikës 1, ajo rikthehet me plotësimin e kushtit. Në rast se leja për transport hiqet në bazë të pikave 2, 3 dhe 4, transportuesi e humbet të drejtën e saj për një afat prej 5 vjetësh nga dita e heqjes së saj. Në rastin e transportit të lirë heqja e lejes për shkelje të neneve të kësaj urdhërese i humbet të drejtën transportuesit për 2 vjet.

Neni 13

Ndalohet të vendosen në mjetet e transportit publik fotografi ose objekte me karakter pornografik. Vendosja e reklamave lejohet vetëm në përputhje me kontratat e lidhura me ndërmarrjet reklamuese.

1. Transporti me autobusë

Neni 14

Autobusi është mjeti motorik i transportit, i prodhuar për transportimin e udhëtarëve e të bagazheve të tyre, i cili ka të montuar në kabinën e tij mbi 9 vende, duke përfshirë edhe shoferin.

Transporti qytetës

Neni 15

Transporti qytetës është ai lloj transporti që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregulltme autobuse brenda vijës kufizuesetë qyteti dhe duke lidhur qendrat ekstreme jetësore me pjesët e tjera të qytetit.

Neni 16

Këshilli i bashkisë organizon dhe miraton rregullin e këtij transporti në rrugët e qytetit të vet, duke përcaktuar veçanërisht:

- rrjetin e linjave, kapacitetin e tyre sipas nevojës së qytetarëve dhe mënyrën e mbajtjes së tij;
- karakteristikat tekniko-shfrytëzuese të autobusëve për mbulimin e linjave;
- mënyrën e organizimit të kontrollit për kryerjen e transportit dhe shfrytëzimin e linjave të transportit;
- lokalizimin e ndalesave të autobusëve, shfrytëzimin dhe ndryshimin e tyre;
- përparësitë në lëvizjen rrugore të qytetit për transportin publik qytetës të udhëtarëve.

Neni 17

Për transportin publik qytetës të udhëtarëve kryetari i bashkisë përcakton kushtet minimale të detyrueshme për numrin e mjeteve të transportit në çdo linjë dhe kohën e lëvizjes së tyre për vijimësinë e transportit të qytetarëve.

Neni 18

Transporti publik qytetës i udhëtarëve me autobusë kryhet nga ndërmarrjet e specializuara për

këtë transport. Në rast se nuk ka të ngritur një ndërmarrje të tillë, kryetari i bashkisë mund t'ia ngarkojë kryerjen e këtij transporti një transportuesi tjetër, i cili ka një numër automjesh që me karakteristikat e tyre tekniko-shfrytëzuese mbulojnë të paktën 50% të rrjetit të miratuar të linjave.

Neni 19

Transportuesi që ngarkohet të kryejë transportin publik qytetës të udhëtarëve, veç kushteve që kërkon kjo urdhëresë, duhet edhe:

- të jetë i regjistruar për kryerjen e transportit qytetës;
- të ketë kapacitetet e veta për parkim e mirëmbajtje të autobusëve;
- të ketë numrin e domosdoshëm të specialistëve për kryerjen e vazhdueshme dhe me kualitet të lartë të transportit;
- të ketë të organizuar një evidencim korrekt të normativave të programuara dhe të mundësojë kontrollin nga organet e bashkisë së qytetit;
- të sigurojë mbajtjen e evidencës së shërbimit kryesor e të klientëve të rastit;
- të sigurojë vazhdimësinë e rritjes së nivelit të shërbimit në transport, nëpërmjet zbatimit të programeve që përputhen me politikën e zhvillimit të transportit të bashkisë së qytetit.

1.2. Transporti jashtë qytetit

Neni 20

Lejet për transport rrugor publik të udhëtarëve me autobusë në linja rrethqytetëse, që lidhin komunat ndërmjet tyre, të ciaoat nuk kanë stacion në qytetet e qendrës së rrethit lëshohen nga organi i ngarkuar për transportin në këshillin e rrethit ku do të kryhet ky transport, me miratimin e kryetarit të këshillit të rrethit . NË të gjitha rastete tjera lejet për transport me autobusë lshohen nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.

Përrjashtohen nga lejet transportet që kryejnë përrsonat juridikë vetëm për transportin e punonjërsve të tyre, me autobusë të vet ose të marrë me qira, dhe vetëm nga qëndra e banimit për në vendin e punës e anasjelltas.

Neni 21

Lejet lëshohen kundrejt pagesës sipas tarifave që caktohen nga Ministria e Transporteve dhe Komunikacioneve, në basjkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Neni 22

Leja për transport rrugor publik me qutobusë miratohet kur transportuesi garanton sigurinë dhe aftësinë ekonomike, si dhe kryerjen e parrezikshme të transportit, nëpërmjet plotësimit të këtyre kushteve:

1. Ka në pronësi një numër të caktuar autobusësh, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të kësaj urdhërese.
2. Numri më i vogël i autobusëve në pronësi për të kërkuar një linjë që ka nevojë për të paktën një autobus linje, nuk duhet të jetë më [ak se dy autobusë.
3. Të ketë, në momentin e bërjes së kërkesës për marrjen e lejes për transport, një kapital të depozituar jo më pak se 8000 USA dollarë (të vlerësuar në lekë), që siguron vazhdimësinë e transportit për çdo ngjarhe të jashtëzakonshme.
4. Të ketë siguruar vetë, ose nëpërmjet një kontrate, mirëmbajtje të vazhdueshme teknike dhe kontroll teknik korrekt të autobusëve.
5. Të ketë siguruar një hapësirë të veçantë për parkimin e gjithë autobusëve.
6. Të ketë bërë punësim të shoferëve të përrshtatshëm për autobusë me kontrata të rregullta pune të siguruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Për plotësimin e kushteve të mësipërme, transportuesi është i detyruar të paraqesë vërtetim me shkrim.

Neni 23

Leja për transport miratohet nga organi kompetent si në nenin 20 të kësaj urdhërese, vetëm nëpërmjet dhënies së ekskluzivitetit të transportuesit a transportuesve që do të kryejnë linjën.

Kur linja për transportin publik të udhëtarëve do të kryhet duke u nisur nga dy qendra të ndryshme banimi dhe nga më shumë se një transportues, domosdoshmërisht ndërmjet transportuesve lidhet kontratë për rregullin e transportit, numrin e autobusëve në linjë, oraret e nisjes, të mbërritjes dhe stacionet. Në këtë rast kërkesa paraqitete në organin kompetent bashkërisht nga transportuesit.

Për numrin e autobusëve të domosdoshëm në linjë transportuesit duhet të kenë së bashku 40 për qind makina rezervë.

Neni 24

Rregulli i koordinuar të transportit në linjë sipas kontratës dhe i miratuar nga organi kompetent regjistrohet në emrin e transportuesve dhe shpallet në stacionet e autobusit.

Afishimi i orarit në stacionet e autobusit për të ghitha linjat që kalojnë në stacion, kryhet detyrimisht nga peroni juridik ose fizik që drejton stacionin e autobusit.

Transportuesi është i detyruar të njoftojë rregullimin e transportit në mjetet e informacionit publik të paktën 10 ditë para fillimit të linjës.

Neni 25

Shitja e biletave për linjat e autobusëve bëhet në stacionet e autobusëve para nisjes së autobusit.

Shitja e biletave, kur kryhet nga vetë agjentët e transportit që posedojnë linjën, bëhet sipas kontratës që lidhet me pronarin e agjencisë.

Me nisjen e autobusit nënkuptohet detyrimi i dyanshëm i agjentit të stacionit dhe i shoferit për pajisjen me fletëudhëtimi, ku vërtetohet nga i pari, me firmë e me vulë dalluese të stacionit, numri i biletave të shitura dhe numri i udhëtarëve që edhëtojnë me atë autobus. Gjatë linjës shoferi nuk ka të drejtë të marrë në autobus udhëtarë pa biletë. Autobusi detyrimisht ndalohet nga shoferi në stacionet ndërmjetësë, me të cilat është lidhur kontratë qëndrimi, e miratuar nga organi kompetent që miraton linjën, për të marrë udhëtarë vetëm për në destinacionin përfundimtar të linjës.

Për shtesat që bëhen në stacione, shënohet në fletëudhëtimi nga agjenti i stacionit numri i udhëtarëve, i vërtetuar si në stacionin e nisjas. Në çdo stacion nisja bëhet vetëm sipas orarit.

Neni 26

Në autobusin e linjës detyrimisht në pjesën e përparme të tij shënohet vendnisja e vendmbërritja e linjës dhe koha e nisjes me kohën e mbërritjes së autobusit.

Neni 27

Gjatë periudhës së funksionimit mundet që në linjë të mbyllen përkohësisht orare të caktuara, ose të pezullohet linja kur rruga ndërpritet për shkaqe madhore, të cilat mund të njoftohen, nga pika të ndryshme të itinerarit të linjës, prej organeve që kanë në pronësi rrugët.

Neni 28

Personi juridik a fizik që drejton stacionet e autobusëve, kruen shërbime ndaj gjithë udhëtarëve të linjave, për të cilat ka përfunduar marrëveshje me transportuesit.

Neni 29

Përsonei juridik a fizik që drejton stacionet e autobusit, nuk ka të drejtë të kryejë shërbime për

transportuesit, të cilët nuk janë me leje të miratuar dhe nuk kanë orar të regjistruar.

Neni 30

Në stacionin e autobusit mbahet dokumentacioni bazë për evidencimin e sasisë së transportit. Evidenca është e përditshme dhe në mënyrë periodike i shpërndahet me përmbledhëse transportuesve për sasinë e mjeteve në linjë dhe numrin e udhëtarëve të transportuar nga secili transportues.

Neni 31

Sistemi i pajisjes me biletra përfshin dhe bagazhet e pagueshme të udhëtarëve. Në këtë rast bileta përbëhet nga dy pjesë: njëra bashkëngjitet me biletën e udhëtarit dhe tjetra lidhet ose i ngjitet bagazhit.

Detyrimisht sistemi i pajisjes me bileta për bagazhet afishohet në stacionet e nisjes së autobusëve.

Neni 32

Personi juridik a fizik, drejtuesi i stacioneve të autobusit, është i detyruar menjëherë, ose në afate të caktuara në kontratën ndërmjet tyre, t'i paguajë të ardhurat e grumbulluara nga shitja e boletave të udhëtimit për llogari të transportuesve, sipas rregullave të pagesave ndërmjet bankës.

Neni 33

Në rastet e transportit të kombinuar tren e autobus që lidhin qytetet e ndryshme nëpërmjet stacioneve hekurudhore, për marrjen e lejes së transportit nevojitet kontrata ndërmjet stacionit hekurudhor nisës, pritës dhe subjektit transportues që merr përsipër kryerjen e linjës

Në këtë rast rregulli i transportit, publikimi i linjës dhe mënyra e shërbimit të dyanshëm përcaktohen në kontratën e përbashkët dhe i propozohen bashkërisht organit kompetent që miraton lejen e transportit.

1.3. Transporti i lirë

Neni 34

Transporti i lirë, jashtë linjave të rregullta, është transporti i udhëtarëve, intenerari, çmimi, shkalla e kryerjes së shërbimit dhe kushtete etjera të të cilit përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejt ndërmjet transportuesit dhe atij që e shfrytëzon transportin.

Kontrata për shfrytëzimin e këtij transporti sipas paragrafit të parë të këtij neni duhet të gjendet në kabinnën e autobusit që e kryen këtë transport.

Neni 35

Transportuesit që kryejnë transport të lirë udhëtarësh, nuk mund të marrin e lënë udhëtarë në stacionet dhe qëndresat e autobusëve.

Neni 36

Përsoneat juridikë a fizikë pronarë të autobusëve mund të kryejnë transport për nevojat e veta, në rast se transportojnë punëtorët e vet a persona të tjerë lidhur me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transport të familjeve të punëtorëve në udhëtime për pushime.

Neni 37

Agjencitë turistike dhe personat e tjerë juridikë a fizikë që nuk kanë në pronësi autobusë për

kryerjen e veprimtarisë së tyre, mund t'i marrin autobusët nga subjektet e tjera nëpërmjet kontratave të qirasë.

Neni 38

Në kabinën e autobusit, me të cilin kryhet transporti i lirë, duhet të jetë detyruesisht dokumenti i pronësisë së mjetit dhe lista e personave që ai transporton, e cila përpilohet nga subjekti klient i transportit.

Kur autobusi merret me qira, në kabinën e autobusit duhet të gjendet edhe kontrata e qirasë, ose kopja e saj e vërtetuar.

1.4. Transporti kombëtar

Neni 39

Transporti rrugor kombëtar kryhet në përputhje me rregullat e kësaj urdhërese dhe marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ai kryhet me autobusë luksozë të pajisur me kondicionerë.

Neni 40

Në rast se me shtete të veçanta nuk janë përfunduar marrëveshje ndërkombëtare, transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve me autobusë kryhet në përputhje me rregullat e kësaj urdhërese dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të përfunduara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Neni 41

Gjatë kryerjes së transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobusë, ekuipazhi i autobusit duhet të njohë rregullat e kësaj urdhërese dhe marrëveshjet ndërkombëtare për transportin rrugor.

Neni 42

Transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve në linja të rregullta me autobusë i nënshtrohet sistemit të lejeve, ku përcaktohet linja, itinerari, ditët dhe orët e nisjes e të mbërritjes dhe çmimet e udhëtimit. Sistemit të lejeve i nënshtrohet edhe transporti vajtje-ardhje i disa grupeve të formuara më parë, ku detyruesisht udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në vajtje kryhet bosh, si dhe hyrja e autobusit bosh për të marrë një grup njerëzish.

Transporti i lirë rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve është transporti, në të cilin itinerari dhe kushtet e tjera janë të rastit dhe janë përcaktuar veçanërisht për çdo transport ndërmjet transportuesit dhe klientit të transportit. Ky lloj transporti nuk i nënshtrohet sistemit të lejeve dhe kryhet me dyer të mbyllura, pa lënë e pa marrë udhëtarë në territorin e Republikës së Shqipërisë qoftë për udhëtimet me qëndrim, qoftë për kalimet tranzite në Shqipëri.

Në rastin e lënies së udhëtarëve kthimi i autobusit është i detyrueshëm bosh për në destinacionin e ardhjes.

Neni 43

Mënyra e licencimit, rregullat dhe organet që ndjekin zbatimin e tyre, të secilit lloj transporti ndërkombëtar me autobusë, ose lejimi i kalimit pa licencë, përcaktohen në marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Organet doganore të pikave të kufirit, ku bëhet kalimi i autobusëve në linja të rregullta ose jashtë linjave (të lira), detyrohen të bëjnë kontrollin dhe konfirmimin e dokumentacionit përkatës të autobusit si më poshtë:

1. Për transportin në linja të rregullta kontrollohen pajisja e autobusit me lejen e lëshuar nga

Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve e Republikës së Shqipërisë (ose fotokopja e saj), si dhe anekset për itinerarin dhe ditët e kryerjes së linjës. Në veçanti për autobusët shqiptarë kontrollohet vërtetimi për mbajtjen e lejes nga autobusi që i përket ndërmarrjes së licencuar.

2. Për transportin e lirë kontrollohet pajisja me fletudhëtimi bashkëngjitur me listën e udhëtarëve mbi të cilën transportuesi deklaron vajtje-kthim (qëndrim i përkohshëm) me dyer të mbyllura, kalim tranzit me dyer të mbyllura ose vajtje plot dhe kthim bosh.

Këto lista konfirmohen në të gjithë kopjet prej organeve doganore të pikave të kufirit që autobusi të kontrollohet në kthim, në pikën doganore të përtejme, ose për kontrolle të rastit në rrugë.

3. Për transportin vajtje-ardhje dhe hyrjen e mjetit bosh kontrollohet leja e dhënë nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve e Republikës së Shqipërisë, ku janë përcaktuar ditët e kalimit të kufirit në hyrje e në dalje dhe numri i udhëtimeve.

Në rast se nuk është përcaktuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, lejet dhe listat e udhëtimit janë sipas modelit që përcaktohet në rregullat e shtetit ku automjeti ka regjistrimin.

Neni 44

Transportuesit shqiptarë mund të fitojnë një leje për kryerjen e transportit të udhëtarëve në linja të rregullta ndërkombëtare me autobusë, kur paraqiten me një punë të sukseshme në transportin e brendshëm për një periudhë jo më pak se një vit.

Neni 45

Kërkesat për leje transporti në linjat ndërkombëtare me autobusë i nënshtrohen testimit për plotësimin e kushteve tekniko-ekonomike që përcaktohen nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve.

Neni 46

Kontrata për linja të rregullta ndërkombëtare me autobusë lidhen për transporte të ndërsjellta ndërmjet transportuesit shqiptar dhe atij të huaj.

Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve pranon kërkesat për miratim, emeton lejet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kujdeset për pajisjen e subjektit vendas me leje kalimi e transporti në shtetet ku kryhet ky transport.

Neni 47

Leja për transport të udhëtarëve në linja të rregullta ndërkombëtare lëshohet kundrejt pagesës, sipas tarifave që caktohen nga Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

KREU III TRANSPORTI AUTOTAKSI

Neni 48

Transporti autotaksi është transport publik udhëtarësh që i nënshtrohet sistemit të lejeve.

Neniv 49

Transporti autotaksi i udhëtarëve dhe i bagazheve të tyre mund të kryhet me mjete transporti të prodhuara për transport njerëzish, që kanë të paktën 5 deri në 9 vende, duke përfshirë shoferi, dhe jo më pak se 4 dyer.

Mjeti autotaksi duhet të qëndrojë në vend të dukshëm për klientin, të jetë i pajisur me një taksimetër të plumbosur nga organet tatimore në rreth ose të ketë të vendosur në një vend të dukshëm për udhëtarin tarifat e shërbimit të miratuara nga këshilli i bashkisë.

Autotaksia duhet të jetë e pajisur me shenjat e dukshme me bojë të pullave në të dy anët e mjetit, si dhe të ketë mbi tavan të montuar një tabelë të ndriçuar, ku të duket mirë emërtimi “TAKSI”.

Mbi bazën e plotësimit të kushteve të mësipërme dhe të kushteve të tjera të përcaktuara në këtë urdhëresë, organi kompetent për transportin në bashki lëshon lejen për transport autotaksi.

Neni 50

Me automjetin e udhëtimit me të cilin kryhet transporti autotaksi i udhëtarëve, nuk mund të kryhet transporti i linjës.

Neni 541

Kryetari i bashkisë përcakton:

- lokalizimin e stacioneve të taksive;
- emërtimin dhe shënimin e tyre.

Nuk lejohet krijimi i stracioneve të taksive dhe qëndrimi i taksive në stacionet qytetëse të autobusëve. Taksitë mund të marrin udhëtarë në stacionet e autobusit vetëm kur janë në lëvizje dhe kjo kërkohet nga qytetari.

Neni 52

Taksitë e një qyteti, që kanë një targë regjistrimi, duhet të jenë të lyera me një ngjyrë, të cilën e cakton kryetari i bashkisë.

KREU IV KONTROLLI DHE KUNËRVAJTJET

Neni 53

Kontrolli për zbatimin e rregullave të kësaj urdhërese kryhet nga organet e specializuara për kontroll ose të autorizuar të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Transportit e të Komunikacioneve.

Neni 54

Për shkeljen e rregullave të kësaj urdhërese merren masat përkatëse administrative nga organet e kontrollit sipas nenit 53 ndaj transportuesit, qiramarrësit e udhëtarit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 55

Transportuesi, pronarët e automjeteve të transportit publik të udhëtarëve dhe personat juridik a fizik që drejtojnë stacionet e autobusëve ose taksive, janë të detyruar që inspektorëve të autorizuar për kontroll, t’u krijojnë kushte normale kontrolli dhe t’u japin të dhënat e nevojshme që kërkojnë.

KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 56

Kur nga organet postare kërkohet me shkrim shfrytëzimi i linjës së autobusit për lëvizjen e objekteve postare, transportuesi është i detyruar të lidhë kontratë me to, me kusht që të mos prishet rregulli i linjës.

Shërbimi për transportin e objekteve postare i nënshtrohet tarifave të transportimit të bagazheve të udhëtarëve që lëvizin në linjë.

Neni 57

Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 22.3.1992 “Për transportin e udhëtarëve dhe bagazheve”, dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhëresë, shfuqizohet.

Neni 58

Kjo urdhëresë hyn në fuqi më 1 nëntor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi